

DEPARTAMENTI I FINANCËS

I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkenca ekonomike në departamentin e Financës

- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, profili "Financë Kontabilitet", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e financës, kontabilitetit ose të përafërta me të.
- b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, me notë mesatare të ponderuar 8 e lart (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND).
- c. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një Universitet të huaj, diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- d. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike ose në fusha të përafërta.
- e. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- f. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor në përputhje me fushat e studimit. Kandidatët duhet të kenë dakortësuar me Udhëheqësit Shkencorë.
- g. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- h. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- i. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e ekonomike ose të përafërta me të.
- j. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar.

II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Financës

1. Nota mesatare vlerësohet maksimalisht me 40 pikë , duke filluar nga 10 pikë nota 8 (tetë), për cdo 0.1, shtohet 1.6 pikë.	(40 pikë maksimalisht)
2. Qendra e punës	(10 pikë maksimalisht)
a. UAMD Me kohe te plote – 10 pikë	
b. Uamd me kohe te pjesshme – 8 pikë	
c. Universitete të tjera publike FT– 6 pikë	
d. Universitete të tjera publike (PT) dhe jopublike (FT+PT) – 4 pikë	
e. Punonjës të institucioneve kërkimore shkencore – 2 pikë	
3. Fusha e studimeve bachelor dhe master	(10 pikë maksimalisht)
a. Financë dhe Kontabilitet - 10 pikë	
b. Shkenca ekonomike – 5 pikë	
c. Shkenca të përafërta – 1 pikë	
4. Rekomandimet (5 pikë për cdo rekomandim)	0-10 pikë
5. Publikime shkencore dhe pjesëmarrje ne konferenca (3 pikë për cdo aktivitet dhe 7 pikë për cdo botim), maksimalisht 10 pikë	0-10 pikë
6. Eksperienca akademike dhe kërkimore shkencore vlerësohet maksimalisht me 10 pikë, duke filluar nga 4 pikë për 2 vite eksperiencë dhe 2 pikë për cdo vit shtesë -max 5 vite vlerësim	0-10 pikë
7. <u>Vlerësimi i Udhëheqësit</u>	0- 10 pikë
TOTALI	0-100 pikë

Aplikanti për tu shpallur fitues renditen në rend zbritës sipas pikëve të fituara për cdo project ku kanë aplikuar.